



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 38 (1,2,3 dhe 4) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 40 Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural shpall:

Konkurs

Lëvizje brenda kategorisë

Të drejtë për aplikim në këtë procedure kanë vetëm nëpunësit civil ekzistues të së njëjtës kategori të punësuar në të njëjtin apo në një tjetër institucion të shërbimit civil.

Titulli i pozitës së punës	Zyrtar i lartë për testimin e cilësisë së ushqimit për kafshë
Klasa e pozitës	Profesional 1
Koeficienti/Paga	koeficienti 8
Nr. i kërkuar	1
Data e njoftimit	30/09/2021
Afati për aplikim	15/10/2021 - 22/10/2021
Institucioni	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Departamenti	Instituti Bujqësor I Kosovës Pejë
Divizioni	
Vendi i punës	Drejtorati i Institutit Bujqësor Pejë
Nr. i Referencës	RN00007639
Kodi	RPC0001463



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

Bën pranimin dhe regjistrimin e mostrave në librin intern të Laboratorit për kontrollin e cilësisë ushqimore.

Përgatitja e procedurave operative standarde dhe validimin e metodës së punës sipas kritereve të standardit ndërkombëtar ISO 17025:2017 për testimin analitik të parametrave të cilësisë së ushqimit për kafshë.

Siguron zhvillimin e procedurave standarde operaionale dhe validimin e metodave per testimin analiti te mostrav3e e te gjitha llojeve te ushqimeve për kafshë , për parametrat analitik sikurse4 janë:Lagështia , Proteinat , Yndyrat , Celuloza, Hiri, P,K,Ca ,Na , MG,Cu,Zn,B.Fe dhe Mn.

Siguron nxjerrjen dhe lëshimin e Raportee3 Laboratorike4 për rezultat e cilësisë së ushqimit me kafshë, konform kritereve të Standardit Ndërkombëtar ISO17205 kritereve të DAK-ut dhe kritereve të Manualit të Cilësisë të Institutit Bujqësor të Kosovës.

Siguron menaxhimi dhe udhëzimi i mostrave të ushqimit për kafshë tek laboratorët tjerë varësisht nga lloji i analizave të kërkuara, respektivisht dërgimi i mostrave tek Laboratori i Mbetjeve kimike oswe Laboraqtori i Mikrobiologjisë Ushqimore.

Monitorimi i kushteve të ambientit punues,,menahimi i pajisjev e laboratorike dhe përgatitja reagjentëve kimik në funksion të aktiviteteve rutine për kryerjen e analizave laboratorike të ushqimeve për kafshë sipas standartiit ndërkombëtar ISO17025:2017

Kontrollon zhvillimin e procedurave të analizave lagboratorike në zbatimm të standardit ndërkombë5tar të BE-së ISO17205 për testimin analitik të ushqimeve me kafshë.

Hulumtimin e metoave dhe teknologjive laboratorike më inovacion për te4stimin aqnalitik të ushqimeve me kafshë.

Kontaktet me shërbimet laboratorike homologe me laboratorët regjional dhe ndërkombëtar , lidhur me standadizimin e procedurave operative dhe valiimin e metodave të reja për testimin e gjithë paraetrave analitik te4k ushqimi për kafshë, si dhe organizon pjesëmarrjen e laboratorit të ushqimeve për kafshë në Testet ndër laboratorike.

2. Kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta

- Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar në detyrë në rastin e lëvizjes brenda kategorisë profesionale.
- Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende.
- Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve te fundit të vlerësimit.
- Në rastin e konkurimit për levizje brenda kategorisë profesionale të jetë vlerësuar të paktën mirë në vitin e fundit.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to (Në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasoje e diplomës Bachelor dhe Master në Fakultetin ose Departamentin e Kimisë.
- Kualifikime të posaçme formale:
- Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.



4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të thellë dhe të specializuara në fushën profesionale specifike;
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësit;
- Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës;
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

5. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve
- Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit
- Dokument që dëshmon se nuk keni ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për lëvizje brenda kategorisë do të shpallet më së largu deri më datën 29/10/2021, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Data, vendi dhe ora ku do të zhvillohet intervista me gojë

- 05.11.2021 Rruga Ukshin Hoti Kompleksi Ramiz Sadiku -Prishtinë

8. Fusha e njohurive, aftësive dhe cilësive që do të vlerësohen në intervistën me gojë

Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.

Njohja e gjuhës angleze.

9. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Intervist

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



12. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranojnë dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

